



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS ADVOKATSKA
KOMORA KOSOVA KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Sipas vendimit të Këshillit Drejtues të datës 27/10/2020, Oda e Avokatëve të Kosovës shpallë,

K O N K U R S
-për vend të lirë të punës-

Duke i berë publike dhe të arritshme për të gjithë:

I. Vendi i punës:

Administrator i zyrës për caktimin e avokateve ex-officio

II. Kushtet:

Përveç kushteve të përgjithshme ligjore për themelimin e marrëdhënies së punës, kandidati duhet t'i plotësojë edhe këto kushte, në lidhje me kualifikimet:

1. Fakultetin juridik
2. 1 vit përvojë pune në lëmine juridike
3. njohja e punës në kompjuter (Programet e Windows-it) e obligueshme
4. njohja gjuhës zyrtare në Kosovë (njohja e gjuhës angleze do të ishte e preferueshme)

III. Përshkrimi i punëve:

- Administratori i zyrës ex-officio kryen këto punë dhe detyra të punës:
- Pranimin e kërkesave nga policia, prokuroria, gjykata, agjensioni i ndihmës
- juridike falas dhe agjensioni për mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave gjate 24 orëve (përmes telefonit) shtatë ditë në javë, për caktimin e avokateve ex-officio
- Plotësimin formave për caktimin e avokateve ex-officio dhe pro-bono
- Identifikimin e zyrtarëve policor, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të cilat shkelin rregullat caktimit të avokateve ex-officio dhe informimin e ZPD për ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme.
- Kontrollon rregullsinë e faturave dhe përgatit vërtetimet për pagesë
- Plotësimin e databazës me detajet e avokatëve të caktuar ex-officio apo pro-bono sipas kërkesave të institucioneve relevante.
- Realizimi i detyrave tjera që dalin nga rregullorja për caktimin e avokatëve ex-officio dhe
- kryen punët tjera sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv

Të kandidatët do të vlerësohen edhe: kreativiteti, shkathtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

IV. Paga:

Koeficienti i pagës: 5.5

V. Dokumentacioni dhe procesi i përzgjedhjes:

Kandidatët të cilët dëshirojnë të paraqiten në konkurs, duhet të sjellin këto dokumente:

- Aplikacionin (i cili plotësohet në OAK në rastin e dorëzimit të dokumenteve)
- Diplomën dhe dokumentet e tjera që dëshmojnë kualifikimet profesionale
- Dëshmi të përvojës së punës
- Letër-motivuese të shkurtër (prej rreth 1 faqe)

Kandidatët e zgjedhur për intervistë do të informohen për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës nga OAK. Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, rr.Bedri Pejani nr.31.

VI. Afati i Konkursit:

Konkursi mbetet i **hapur 8 ditë** nga dita e publikimit përkatesisht deri me datë **05/11/2020 ora 16:00**.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim, sikur edhe ata kandidatët të cilët nuk i përgjigjen ftesës për intervistim dhe nuk i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes.

Informatat:

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të lajmërohen në:038/244-586 dhe

E-mail: info@oak-ks.org